



Elida Trushaj
E. Trushaj

[Handwritten signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2003 / Prot.
3

Vlorë më, 19.12. 2022

VENDIM

Nr. 45, datë 19.12.2022

E. Trushaj
[Handwritten signature]

PËR
HAPJEN DHE MIRATIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMIN E
CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE DOKTORATË NË SHKENCAT E
SHËNDETIT

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, gërma ç, nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, pika 1, gërma i, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.04.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Fakultetit të Shëndetit nr. 240/1 prot, si dhe propozimit të Administratorit ardhur me shkresën nr. 1828/2 prot, datë 06.12.2022, Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 19.12.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shëndetit, për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit".
2. Të miratojë tarifën e shkollimit për të gjithë kohëzgjatjen e programit të studimit "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit", në masën 600,000 lekë.
3. Masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit do të mbulohet nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe nuk kërkohet financim shtesë nga Buxheti i shtetit.
4. Ngarkohet për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shëndetit, Administratori, Zv.Rektori për kërkimin shkencor dhe zhvillimin institucional dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sotir NIKOLLA



Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

[Handwritten signature of Sotir Nikolla]